

V E N D I M
Nr. 549, datë 26.8.1996

**PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME**

(Ndryshuar me VKM nr. 143, datë 26.2.1998; nr. 292, datë 24.4.2003)

(i përditësuar)

Në mbështetje të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifat”, neni 3, të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 54 dhe 56, me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të rretheve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

**LISTA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË PASURISË
SË PALUAJTSHME**

(Ndryshuar me VKM nr. 143, datë 26.2.1998; shtuar pikat 22, 23 dhe 24 me VKM nr. 292, datë 24.4.2003)

LLOJI I SHËRBIMIT

LEKË

1. Lëshimi i certifikatave të pasurisë	400
2. Kërkesa për regjistrimin e pronësisë të pasurisë së paluajtshme	200
3. Kërkesa për regjistrimin e pjesëtimit , ndarjes ose bashkimit të pasurisë së paluajtshme	300
4. Kërkesa për konsultim të kartelës dhe të të dhënave të tjera të pasurisë së paluajtshme	200
5. Kërkesa për kontroll zyrtar të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme	500
6. Kërkesa për lëshimin e kopjes së certifikatës së pasurisë së paluajtshme	300
7. Kërkesa për saktësimin e kufijve	1500
8. Kërkesa për përgatitjen e dokumenteve për në gjykatë, ose organ tjetër administrativ	500
9. Kërkesa për regjistrimin për kalim pronësie, qiraje, nënqiraje	1500
10. Kërkesa për regjistrim hipoteke ligjore	500
11. Kërkesa për regjistrim për fshirje hipoteke ligjore	500
12. Kërkesa për regjistrim për fshirjen e një vendimi gjykate a të një akti administrativ	500
13. Kërkesa për regjistrim servituti, marrëveshje kufizuese	600
14. Kërkesa për regjistrim fshirjen e një servituti, marrëveshjeje kufizuese	600
15. Regjistrimi i kërkesave për heqje dorë nga të drejtat pasurore mbi pasurinë e paluajtshme	200
16. Regjistrimi i kërkesave për fitimin e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme me trashëgimi	200
17. Kërkesa për regjistrimin e veprimeve juridike mbi pasuritë e paluajtshme nga personat fizikë dhe juridikë me banim jashtë shtetit	1500
18. Kërkesa për korrigjimin e gabimeve materiale në kartelë	200
19. Kërkesa për lëshim kopje karte, harte treguese ose pjese të saj	400
20. Kërkesa për fotokopje të dokumenteve të pasurive të paluajtshme për çdo faqe	50
21. Lëshimi vërtetimit të pronësisë	50
22. Regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme në zonat urbane: - pa rilevim e azhurnim të pasurive nga zyrat e regjistrimit të pasurive;	3000
- me rilevim dhe azhurnim të pasurisë nga zyrat e regjistrimit të pasurive.	6000
23. Shërbime për veprimet e bankave dhe institucioneve të tjera kredidhënëse. - Për kredi në vlerë deri 1 000 000 lekë;	3000
- Për kredi me vlerë nga 1 000 001 deri në 10 000 000 lekë;	6000
- Për kredi me vlerë mbi 10 000 000 lekë.	10 000
24. Regjistrimi mesatar i veçantë i pasurive të paluajtshme në zonat rurale.	30 000